



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Nr. 367/17 prot.

Tiranë, më 11.12.2023

VENDIM

Nr.113, datë 11.12.2023

PËR

**MIRATIMIN E RREGULLORES
MBI KRITERET DHE PROCEDURAT PËR SHQYRTIMIN, MIRATIMIN DHE
ZBATIMIN E PROJEKTEVE**

TË AMA-S

Në mbështetje të nenit 19, pika 1, gërma "e" të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA),

V E N D O S I:

1. Miratimin e Rregullores "Mbi kriteret dhe procedurat për shqyrtimin dhe miratimin dhe zbatimin e projekteve" sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohet administrata e AMA-s për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar:

Armela

KRASNIQI

Zëvendëskryetar:

Desada

METAJ

Anëtarë:

Aurela

BICJA

Besian

ZOGAJ

Gjergji

HAMITI

Jetmir

HALILAJ

Joana

ALLUSHI



AUTORITETI I
MEDIAVE
AUDIOVIZIVE

Rr. "Papa Gjon Pali II", Nr. 15, 1010, Tiranë | www.ama.gov.al
Tel. +355 4 2233006 | Email. info@ama.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE
DREJTORIA E BOTIMEVE DHE NDËRVEPRIMIT
(Miratuar me vendim nr.113, datë 11.12.2023 të AMA-s)

RREGULLORE

“MBI KRITERET DHE PROCEDURAT PËR SHQYRTIMIN, MIRATIMIN DHE ZBATIMIN E PROJEKTEVE”

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

NENI 1
BAZA LIGJORE

Kjo rregullore hartohet në zbatim të neneve 19, pika 2 germa c, 23, pika 1, germa ç, dhe 50 pika 1 të ligjit nr.97/2013, datë 19.03.2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

NENI 2
QËLLIMI

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kriterëve dhe procedurave për Thirrje për aplikim në mbështetje të projekt-propozimeve në fushën e mediave audiovizive.

NENI 3
OBJEKTI

Objekt i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave, kriterëve dhe procedurave për:

1. Financimin me fonde në mbështetje të projekteve që kanë për qëllim realizimin e studimeve dhe kërkimeve sasiore dhe cilësore, aktiviteteve kualifikuese dhe trajnuese, fushatave informuese dhe sensibilizuese, botimeve dhe përkthimeve në fushën e medias.

2. Përcaktimin e dokumentacionit dhe kriterëve për pranimin, shqyrtimin dhe vlerësimin e projekt-propozimeve të paraqitura.
3. Funksionimin e Komisionit për Hartimin e Dokumentacionit dhe Ndjekjen e Procedurës.

NENI 4

PROGRAMI VJETOR I FINANCIMEVE

1. Drejtoria e Botimeve dhe Ndërveprimit, në konsultim dhe koordinim me Këshillin e Ankesave dhe drejtoritë e tjera propozojnë tematikat kornizë në përputhje me strategjinë e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA).
2. Tematikat e propozuara shoqërohen me relacion shpjegues për qëllimin e temave në këtë fushë, produktet që kërkohen, rezultatet e pritshme dhe fondin maksimal që AMA vendos në dispozicion për çdo temë kornizë.
3. Brenda muajit dhjetor të çdo viti, bazuar në strategjinë dhe objektivat e AMA-s dhe propozimet e njëjësive, Drejtoria e Botimeve dhe Ndërveprimit përgatit programin vjetor “PËR PJESËMARRJE NË KONKURRIM PËR MBËSHTETJE ME FONDE”, që institucioni planifikon të organizojë gjatë vitit.

KREU II

DOKUMENTACIONI DHE PROCEDURA PËR APLIKIM

NENI 5

SUBJEKTET PROPOZUESE

1. Subjektet që mund të paraqesin kërkesa për projekt-propozime pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, duhet të jenë subjekte që kryejnë veprimtari në fushën e medias dhe të përmbushin kriteret si më poshtë:
 - a) Të jenë institucione dhe organizata joqeveritare;
 - b) Të jenë persona juridikë publikë;
2. Nuk mund të paraqesin projekt-propozime partitë politike, sindikatat apo organizatat politike.
3. Autoriteti i Mediave Audiovizive, nuk mbështet projekt-propozime që kanë lidhje pronësie direkte apo indirekte me OSHMA-të.
4. Subjektet të cilat kanë projekte në proces të mbështetur nga AMA, nuk kanë të drejtë të aplikojnë përpara përfundimit dhe paraqitjes së raportit final të këtij projekt

NENI 6

SHPALLJA PUBLIKE E THIRRJES

1. Njoftimi për “THIRRJE PËR PROJEKT-PROPOZIME”, shpallet në faqen e internetit të Autoritetit të Mediave Audiovizive, bashkë me formularin e aplikimit dhe formularin e projekt-preventivit.
2. Thirrja do të jetë e hapur minimalisht 30 ditë pune në faqen zyrtare të Autoritetit të Mediave Audiovizive.
3. Gjatë kohës kur thirrja është e hapur, subjektet e interesuara mund të kërkojnë sqarime/informacione përmes postës elektronike apo në mënyrë zyrtare, por jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë pune para përfundimit të afatit të aplikimit së thirrjes publike.
4. Komisioni për Hartimin e Dokumentacionit dhe Ndjekjen e Procedurës do të japë sqarime/përgjigje me shkrim vetëm për pyetjet e bëra nga subjektet e interesuara, të paktën 10 (dhjetë) ditë para përfundimit të afatit të aplikimit.
5. Dorëzimi i aplikimeve bëhet në zarf të mbyllur, i cili përmban një kopje të printuar të të gjithë dokumentacionit origjinal të kërkuar, si dhe një kopje elektronike në CD.
6. Mbi zarfin e aplikimit të shënohet “Thirrje për aplikim” si dhe të shkruhen të dhënat e thirrjes(nr, datë, titull i thirrjes).

NENI 7

MËNYRA E APLIKIMIT DHE DOKUMENTACIONI SHOQËRUES

1. Kërkesa për projekt-propozimin dërgohet në rrugë postare, ose dorazi pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, dhe shoqërohet me dokumentacionin përkatës, të përcaktuar në pikën 3 të këtij neni.
2. Kërkesa dhe dokumentacioni shoqërues duhet të jenë në gjuhën shqipe.
3. Dokumentacioni i kërkuar për aplikim për subjektet e nenit 5, pika 1, gërma a) dhe b) e kësaj rregulloreje është:
 - a) Kërkesë për miratim të projekti-propozimit;
 - b) Formatin e aplikimit sipas modelit në **aneksin 1** të kësaj rregulloreje;
 - c) Jetëshkrimin profesional të grupit të punës që do të zhvillojë projektin;
 - d) Fotokopje të dokumentit të identifikimit të personit/personave që do të zhvillojë/zhvillojnë projektin;
 - e) Ekstraktin e Gjykatës për regjistrimin e subjektit në Republikën e Shqipërisë (i cili merret në Zyrën e Regjistrimit të OJF-ve, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë) - origjinal ose kopje e noterizuar, lëshuar brenda 3-mujorit të fundit.
 - f) Dokumentin e regjistrimit në organin tatimor (NIPT)/Ekstrakt Historik QKB si dhe Vërtetim që organizata është me status aktiv në momentin e aplikimit.
 - g) Vetëdeklarim i gjendjes gjyqësore i personave që do të zbatojnë projektin;

- h) Informacion mbi financimin e projektit; (projekt-propozimi të jetë i shoqëruar me projektbuxhet, sipas formatit të përcaktuar sipas thirrjes publike dhe **aneksin 1** të kësaj Rregulloreje)
 - i) Në planin buxhetor të projekt-propozimit, vetë subjekti aplikues, detyrimisht duhet të ketë të pasqyruar një angazhim vetë financues jo më pak se 25% të vlerës totale të buxhetit.
 - j) Vërtetim që nuk ka detyrime të pashlyera të detyrimeve tatimore dhe të sigurimeve shoqërore, të tre muajve të fundit nga data e aplikimit.
 - k) Vërtetim për numër llogarie bankare, në Lekë.
 - l) Deklaratë nga subjekti aplikues që nuk ka pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete.
 - m) Informacion për kontributin e dhe angazhimin e subjektit në fushën e medias dhe projektet e mëpërparshme që ka realizuar.
4. Komisioni për Hartimin e Dokumentacionit dhe Ndjekjen e Procedurës mund të kërkojë informacion shtesë për t'u bindur për dobinë dhe përshtatshmërinë e projekt-propozimeve të paraqitura prej subjekteve.

KREU III

SHQYRTIMI I PROJEKT-PROPOZIMEVE

NENI 8

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E KOMISIONIT PËR HARTIMIN E DOKUMENTACIONIT DHE NDJEKJEN E PROCEDURËS

1. Shqyrtimi i projekt-propozimeve që paraqiten në përgjigje të “THIRRJES PËR PROJEKT-PROPOZIME” realizohet nga Komisioni për Hartimin e Dokumentacionit dhe Ndjekjen e Procedurës, me të paktën 5 (pesë) anëtarë, i ngritur me Urdhër të Brendshëm të Sekretarit të Përgjithshëm.
2. Komisioni për Hartimin e Dokumentacionit dhe Ndjekjen e Procedurës për shqyrtimin e projekt-propozimeve duhet të ketë në përbërjen e tij të paktën një anëtar nga Drejtoria e Botimeve dhe Ndërveprimi, një anëtar nga Drejtoria Ligjore dhe një anëtar nga Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve.
3. Komisioni për Hartimin e Dokumentacionit dhe Ndjekjen e Procedurës ka këto detyra dhe përgjegjësi:
 - a) Të hartojë dokumentacionin për shpalljen e Thirrjes publike,
 - b) Të vlerësojë aplikimet nëse plotësojnë dokumentacionin e përcaktuar në nenin 7 të kësaj Rregulloreje dhe të vendosë nëse aplikantët i plotësojnë kriteret për t'u kualifikuar në fazën e vlerësimit të përmbajtjes.

- c) Të shqyrtojë dhe vlerësojë propozimet e aplikantëve të kualifikuar për fazën e dytë për mbështetje financiare nga aspekti përmbajtësor, sipas kritereve të përcaktuara në nenin 9 të kësaj Rregulloreje;
 - d) Të sigurojë që projekt-propozimet e përzgjedhura për mbështetje financiare i plotësojnë të gjitha kriteret e thirrjes publike.
 - e) Të përzgjedhë përfituesit e mbështetjes financiare sipas thirrjes publike, kualifikimeve dhe eksperiencës të subjekteve aplikues.
4. Secili nga anëtarët e Komisionit për Hartimin e Dokumentacionit dhe Ndjekjen e Procedurës, para se të bëjë vlerësimin nënshkruan deklaratën mbi shmangien e konfliktit të interesit dhe ruajtjen e fshehtësisë së informacionit në vendimmarrje.
 5. Në përfundim të procesit të shqyrtimit, Komisioni për Hartimin e Dokumentacionit dhe Ndjekjen e Procedurës nxjerr Procesverbal Vlerësimi me shkrim, ku përcaktohen aplikantët e kualifikuar për përfitim të mbështetjes financiare.
 6. Procesverbali i Vlerësimit nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Projekteve, përveç rasteve kur mungesa e anëtarit të grupit është e justifikuar me raport mjekësor ose leje vjetore.
 7. Komisioni për Hartimin e Dokumentacionit dhe Ndjekjen e Procedurës mban procesverbal për gjithë procesin e vlerësimit të projekt-propozimeve që nga procesi i hapjes së aplikimeve deri te marrja e vendimit.

NENI 9

ANALIZIMI I PROJEKTIT

1. Aplikimet i nënshtrohen fazës së dytë të vlerësimit pasi verifikohet plotësimi i të gjithë dokumentacionit të kërkuar sipas kritereve të përcaktuara.
2. Në rast se evidentohen mangësi të dokumentacionit/eve, aplikimi refuzohet, nuk shqyrtohet dhe i argumentohet aplikuesit/subjektit shkak i refuzimit në rrugë zyrtare nga Komisioni për Hartimin e Dokumentacionit dhe Ndjekjen e Procedurës;
3. Komisioni për Hartimin e Dokumentacionit dhe Ndjekjen e Procedurës ka në dispozicion 100 pikë për fazën e dytë të vlerësimit të aspektit përmbajtësor të projekt-propozimet sipas kritereve të mëposhtme:
 - a) Përputhshmëria e projektit me kërkesat e Thirrjes (20 pikë).
 - b) Dobia e objektivave që synohen të realizohen përmes zbatimit të projektit (10 pikë).
 - c) Cilësia e grupit te punës, sa dhe si ata janë kontributorë në fushën e medias, veçanërisht në median audio/audiovizive etj (10 pikë).
 - d) Përputhshmëria e projektit me prioritetet strategjike të Autoritetit të Mediave Audiovizive, në kohën e propozimit (20 pikë).
 - e) Zbatimi i projektit (përcaktimi i afateve kur do të zbatohet projekti) (10 pikë).
 - f) Buxheti dhe efikasiteti i kostos (10 pikë).
 - g) Eksperiencat e mëparshme në fushën e medias (20 pikë).

4. Projekt-propozimi kualifikohet për mbështetje financiare nëse vlerësohet me të paktën 70 pikë nga Komisioni për Hartimin e Dokumentacionit dhe Ndjekjen e Procedurës.

NENI 10

PËRFUNDIMI I VLERËSIMEVE DHE ANKESAT

1. Pas mbylljes së datës përfundimtare të paraqitjes së projekt-propozimeve, Komisioni për Hartimin e Dokumentacionit dhe Ndjekjen e Procedurës brenda 14 ditëve kalendarike njofton aplikuesit për rezultatet e vlerësimit të projekt-propozimeve.
2. Komisioni për Hartimin e Dokumentacionit dhe Ndjekjen e Procedurës ka të drejtë të kërkojë sqarime shtesë në lidhje me projekt-buxhetin bazuar në listën e tarifave të referencës.
3. Aplikanti ka të drejtë të ankimojë vendimin e Komisionit për Hartimin e Dokumentacionit dhe Ndjekjen e Procedurës brenda 5 ditë pune.
4. Ankesat nga subjektet shqyrtohen brenda 5 ditëve pune nga një Komision i ngritur me urdhër të Sekretarit të Përgjithshëm me përbërje specialistë të fushës.
5. Pas shqyrtimit të ankimit, Komisioni për Hartimin e Dokumentacionit dhe Ndjekjen e Procedurës shpall fituesin përfundimtar të projektit dhe e njofton atë për lidhjen e kontratës.

NENI 11

KONTRATA ME PËRFITUESIN

1. Titullari i institucionit lidh kontratë me shkrim me përfituesin e mbështetjes financiare brenda 14 ditësh nga dita e shpallës së fituesit.
2. Kontrata me përfituesin përmban:
 - a) Detaje lidhur me shumën e financimit, periudhën e zbatimit, monitorimin e zbatimit dhe raportimin për projektin/programin e përfituesit;
 - b) Dispozita me të cilat përcaktohet qartë se cili është qëllimi i mbështetjes financiare dhe ndalimin e përdorimit të mjeteve për qëllime tjera;
 - c) Dispozita me të cilat përfituesi detyrohet, që mjetet nga mbështetja financiare t'i shpenzojë përmes transaksioneve bankare në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe të vërtetohet me fatura të fiskalizuara, etj.
 - d) Dispozita sqaruese për mënyrën dhe afatet e pagesës duke përfshirë shumën e paradhënies;
 - e) Dispozita për shmangien e konfliktit të interesit gjatë shpenzimit të mjeteve nga mbështetja financiare;
 - f) Dispozita për rastet e zgjidhjes së kontratës;
 - g) Dispozita për modalitetet e kthimit të mjeteve në rast të zgjidhjes së kontratës.

NENI 12

PROCESI I MONITORIMIT DHE RAPORTIMIT

1. Subjekti fitues i projektit raporton tek Komisioni për Hartimin e Dokumentacionit dhe Ndjekjen e Procedurës lidhur me zbatimin e projektit, sipas kërkesave të përcaktuara në kontratë.
2. Përfituesi mund të depozitojë në Autoritetin e Mediave Audiovizive deri në 1(një) Raport të ndërmjetëm Përshkrues dhe Financiar, duke kërkuar jo më shumë se 50% të fondit të përgjithshëm dhe pasqyruar realizimet e pritshme të projektit deri në përfundim të tij.
3. Pagesa finale e projektit do të kryhet nga Autoriteti Financues sipas kontratës, pas dorëzimit në Autoritetin e Mediave Audiovizive të raportit final Përshkrues dhe Financiar nga subjekti fitues mbi realizimin përfundimtar të projektit.
4. Në përfundim të projektit, çdo subjekt i përcaktuar në nenin 8 të kësaj rregulloreje, të cilit i është miratuar kërkesa për zbatim projekti, ka detyrim që 10 ditë nga afati përfundimtar të dërgojë në Autoritetin e Mediave Audiovizive një raport përmbledhës për zbatimin e projektit.
5. Në rastet e shkeljeve të rënda të kontratës, Titullari i Institucionit nxjerr vendim për anulimin e kontratës si dhe për iniciimin e procedurave gjyqësore përkatëse.

Neni 13

Hyrja në fuqi

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Autoriteti i Mediave Audiovizive në përputhje me ligjin nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
2. Kjo Rregullore publikohet në faqen zyrtare të internetit të Autoritetit të Mediave Audiovizive.
3. Me Hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore shfuqizohet Udhezimi (Nr.200 Prot., datë 12.01.2018) “Për Përcaktimin e Rregullave dhe Procedurave për Thirjet për Aplikim të Projekt-Propozimeve në fushën e Mediave Audiovizive”.